REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2136/4 Prot Rrëshen, më 29. 05. 2026

# V E N D I M

**Nr. 33 datë 26. 05. 2026**
**PËR**
**"MIRATIMIN, NDËRTIM/RIKONSTRUKSION RRUGË AUTOMOBILISTIKE, ME GJATËSI RRETH 635 ML (0.635 KM), QË LIDH LAGJEN "NDREJAJ", FSHATI PERLAT EPËRM ME RRUGËT EKZISTUESE TË ZONËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË, 4606", BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", të ligjit 139/2015, "Për vetqeverisjen vendore", *i ndryshuar*, neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" *të ndryshuar*, neni 6, gërma "i", të VKM nr. 408, datë 13. 05. 2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" *të ndryshuar* me VKM nr. 686, datë 22. 11. 2017, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", ligji nr. 57/2020 ,"Për pyjet" *i ndryshuar*, VKM nr. 888, datë 27.12.2022, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit pyjor/kullosor", Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016, i Ministrit të Mjedisit, "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të këkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Urdhërit nr. 234, nr. 2136 prot, datë 13.05.2026, i Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e Grupit të Punës për raportin tekniko-ekonomik, për gjurmën e rrugës në lagjen Ndrejaj, fshati Perlat Epër", Relacioni nr. 2136/2 prot, datë 22.05.2026, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), *shqyrtimin/miratimin në mbledhjen e datës 25.05.2026, të Komisionit të Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës,* për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve

## V E N D O S I:

1. Miratimin e ndërtim/rikonstruksion të rrugës utomobilistike, që fillon me gjatësi rret 635 ml (0.635 km) që lidh lagjen "Ndrejaj", fshati Perla Epërm, me rrugët ekzistuese të zonës, njësia administrative Kthellë, 4606, Bashkia Mirditë

   - Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 0.222 ha, me gjatësi rreth 635 ml (0.635 km) dhe gjërësi mesatare rreth 3.5 m, fond pyjor/kullosor publik, n/ngastrat pyjore nr. 25b, Ekonomia pyjore/kullosore "Perlat Shebe", në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë, njësia administrative Kthellë

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

2. Plani i vendosjes së gjurmës së rrugës në Sh. 1:2 000, Raporti nr. 2136/1, prot "Mbi studimin teknik-ekonomik të sipërfaqes për fondin pyjor/kullosor publik" & Relacioni nr. 2136/2, prot, datë 22.05.2026, *bashkëlidhur, pjesë përbërse këtij vendimi*

3. Volume të materialit drusor i dalë nga hartimi i raportit të studimit teknik-ekonomik, gjatë kryerjes punimeve, të bëhet hyrje në magazinë dhe të përdoret për nevojat e institucionit të Bashkisë Mirditë

4. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë

5. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë

6. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, APPM-Mirditë dhe Njësia Administrative Kthellë)

*Ky vendim hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

**S E K R E T A R**

**Gaspër TOPOLLAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

**K R Y E T A R**

**Aleksandër PICAKU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 2136/3 Prot**

**Rrëshen më, 22. 05. 2026**

**P/VENDIM**

**Nr. 52 , datë 22. 05. 2026**

**PËR**

**"MIRATIMIN E NDËRTIM/RIKONSTRUKSION RRUGE AUTO, ME GJATËSI RRETH 635ML (0.63KM), QË LIDH LAGJEN "NDREJAJ", FSHATI PËRLAT I EPËRM ME RRUGËT EKZISTUESE TË ZONËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (*të ndryshuar*), neni 6, gërma "i", të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", (*të ndryshuar*), ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", VKM Nr. 888 datë 27.12.2022 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të siprfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"; në VKM Nr. 1374 datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik". Urdhërit nr. 234, Nr. 2136 Prot., datë 13.05.2026, të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e grupit të punës së raportit tekniko-ekonomik, për gjurmën e rrugës në lagjen Ndejaj, fshati Përlat i Epërm, Kthellë", projekt –vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndërtim/rikonstruksion rruge auto, me gjatësi rreth 635ml (0.63km) që lidh lagjen "Ndrejaj" fshati Përlat i Epërm, me rrugët ekzistuese të zonës, njësia administrative Kthellë.
   - Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 0.222ha, me gjatësi rreth 635 ml (0.63 km) dhe gjerësi mesatare rreth 3.5m, fond pyjor/kullosor pubik, n/nëngastrat pyjore Nr. 25b Ekonomia pyjore/kullosore Përlat Shebe, në administrim/pronësi të bashkisë Mirditë, njësia administrative Kthellë.
2. Plani i vendosjes së gjurmës së rrugës Sh. 1: 2,000, Raporti nr. 2136/1 Prot., datë 21.05.2026, studimin tekniko-ekonomik të sipëfaqes për fondin pyjor, *pjesë përbërse këtij vendimi*
3. Volume të materialit drusor i dalë nga hartimi i raportit të studimit teknik-ekonomik, gjatë kryerjes punimeve, të bëhet hyrje në magazinë dhe të përdoret për nevojat e institucionit të Bashkisë Mirditë

4. Punimet dhe mirëmbajtja e rrugës automobilistike, do të kryhen nga komuniteti i zonës dhe Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë

5. Pas ndërtimit, rruga do të jetë në përdorim të të gjithë komunitetit dhe pronë e bashkisë Mirditë dhe në inventarin e Agjencisë së Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë.

6. Për ndjekje e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet bashkia Mirditë, (Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit, APPM-Mirditë dhe njësia administrative Kthellë).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (të ndryshuar)!*

**SEKRETARI**
**Gasper TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksandër PICAKU**

**Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:**

**Ing. Gjeodet A. Dedaj**

**Dr. Ark. J. Tusha**

**Zyra Juridike: Juriste L. Gjergji**

**K R Y E T A R I**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 2136/2 Prot** **Rrëshen më, 22.05.2026**

**RELACION**

**PËR PROJEKTVENDIMIN PËR**
**"MIRATIMIN E NDËRTIM/RIKONSTRUKSION RRUGE AUTO, ME GJATËSI RRETH 635ML (0.63KM), QË LIDH LAGJEN "NDREJAJ", FSHATI PËRLAT I EPËRM ME RRUGËT EKZISTUESE TË ZONËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1 shkronja "b", të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", neni 3, pika 11, të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" (*të ndryshuar*), neni 6, gërma "i", të VKM.nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", (*të ndryshuar*), ligji nr. 57/2020 "Për pyjet", VKM Nr. 888 datë 27.12.2022 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"; në VKM Nr. 1374 datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik". Urdhërit nr. 234, Nr. 2136 Prot., datë 13.05.2026, të Kryetarit të Bashkisë, "Për ngritjen e grupit të punës së raportit tekniko-ekonomik, për gjurmën e rrugës në lagjen Ndejaj, fshati Përlat i Epërm, Kthellë", projekt –vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë (Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit), në këshillin bashkiak, pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit bashkiak.

**Të nderuar Këshilltarë,**

Ky relacion paraqitet në mbështetje të projektvendimit për ndërtim/rikonstruksion rruge auto, me gjatësi rreth 635ml (0.63km) që lidh lagjen "Ndrejaj" fshati Përlat i Epërm, me rrugët ekzistuese të zonës, njësia administrative Kthellë, duke përmirësuar infrastrukturën dhe aksesin për komunitetin.

**Përshkrimi i studimit teknik–ekonomik**

Sipërfaqja e gjurmës së rrugës: rreth 0.222 ha, me gjatësi rreth 635 ml (0.63km) me gjerësi mesatare rreth 3.5m.

Zona është pjesë e fondit pyjor/kullosor publik, n/nëngastrën pyjore nr. 25b, Ekonomia pyjore/kullosore Përlat Shebe, nën administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë.

Përshkrimi i parcelës pyjore objekt studimi, ku kalon gjurma e rrugës auto për ndërtim/rikonstruksion, tregon kryesisht tokë me pyll të llojit dushqe dhe shkurre me një shkallë mbulimi rreth 50% të sipërfaqes.

Ndërhyrjet e parashikuara nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesorë të sipërfaqes pyjore/kullosore bashkiake.

**Argumentimi i nevojës**

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim të sipërfaqeve nga fondi pyjor dhe kullosor public mbështeten në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht me VKM Nr. 888 datë 27.12.2022 "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të siprfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor"; në VKM Nr. 1374 datë 10.10.2008 "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

Ndërtimi/rikonstruksioni dhe vënia në funksion e këtij segmenti rrugor paraqet një investim me interes të drejtpërdrejtë publik, i cili jo vetëm plotëson nevojat e përditshme të komunitetit të zonës, por garanton edhe akses të shpejtë dhe efektiv për strukturat e emergjencave civile dhe shërbimin zjarrfikës në rastet e zjarreve në pyje. Gjithashtu, ky investim kontribuon në rritjen e kapaciteteve operacionale të strukturave të mbrojtjes civile dhe të organeve ligjzbatuese, duke mundësuar monitorim dhe kontroll më të efektshëm të territorit.

**Konkluzion**

Për sa më sipër, realizimi i këtij projekti përmbush kriterin e interest publik dhe përbën një ndërhyrje të domosdoshme për përmirësimin e infrastrukturës, garantimin e sigurisë publike dhe forcimin e mekanizmave institucionalë për administrimin dhe mbrojtjen e territorit.

**Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit:**

**Ing. Gjeodet A. Dedaj**

**Dr. Ark. J. Tusha**

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA MIRDITE
AGJENCIA E BUJQESISË UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE

Nr.2136/1 Prot. Rrëshen më 21.05.2026

# RAPORT

## MBI STUDIMIN TEKNIKO – EKONOMIK TË SIPËRFAQES PYJORE/KULLOSORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË MIRDITË, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË.

*" Ndertim/Rikonstruksion rruge auto, me gjatësi rreth 635 ml(0.63 km), që lidh lagjen " Ndreaj, me rrugët ekzistuese të zonës, Njësia administrative Këthellë ".*

Në zbatim të Urdhërit nr 234, date 13.05.2026 të Kryetarit të Bashkise për hartimin e raportit të studimit tekniko–ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore që përshkon gjurma e projektuar për ndërtimin/rikonstruksionin e një segmenti rruge auto pyjore, me gjatësi rreth 0.63 km, që lidh lagjen " NDREAJ ", fshati Perlat-Epër, me rrugën ekzistuese të zonës, njësia administrative Kthellë. Grupi i punës i përbërë nga; Gjovalin Nikollli, Preng Nikolli dhe Eneida Nikolli, Sektori i monitorimit dhe sherbimit pyjor në Bashki, pasi u njoh me Urdhërin e Kryetarit të bashkisë, dhe administroj dokumentacionin teknik të gjurmës së rrugës, realizoi verifikimin e objektit në terren, të dhënat në rregjistrin kadastral të pyjeve/kullotave bashkiake, dhe planin e regullimit të territorit të Bashkisë Mirditë, konkludoj si më poshtë.

Sipërfaqja që përshkon gjurma e rrugës është rreth 0.222 ha, me gjatësi rreth 635 ml (0.63 km) dhe gjerësi mesatare rreth 3.5 m, fond pyjor/kullosor publik, n/nëngastrat pyjore nr.25b, Ekonomia pyjore/kullosore Perlat Shebe, në administrim/pronësi të Bashkisë Mirditë, njësia administrative Kthellë.

Gjurma e kësaj rruge përkon kryesisht me gjurmëën e rrugës këmbësore që të dërgon në këtë lagje.Nga përshkrimi parcelar i sipërfaqes pyjore objekt studimi, ku kalon gjurma e rrugës auto për ndertim/rikonstruksion (formularët 1 dh 2 bashkëngjitur), rezulton kryesisht tokë me pyll të llojit dushqe,dhe shkurre me një shkallë mbulimi rreth 50% të sipërfaqes.

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin Teknik dhe të verifikuara në terren, nuk e ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverisjes dhe treguesit kryesor të sipërfaqes pyjore/kullosore bashkiake.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

Ndertimi dhe vënja në funksion të plotë i këtij segmenti rruge auto, i shërben mjaftueshëm jo vetëm nevojave të përditëshme të komunitetit të kësaj zone, sidomos për rastet e emergjencave civile, shërbimin zjarrfikës në raste zjarri në pyje, por dhe në rritjen e efikasitetit të struktuarave të shërbimit civil në përgjithësi, dhe të strukturave ligjëzbatuese në monitorimin dhe kontrollin e teritorit në veçanti.

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në V.K.M-ve nr 888, datë 27.12.2022, " Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe proçedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", në VKM-ve nr 1374, date 10.10.2008, të ndryshuar " Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor ", në Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit nr. 01 datë 09.06.2016" "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik ".

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, Ndërtimi i rrugës fillon, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë, dhe likujdimit të tarifës prej **32950** lekë.

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve nr. 599, datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave ", të ndryshuar, bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

**a) Vlerën e përdorimit, 000 lek/ha/vit.**

Trungishte 000 ha x 000 lek = 000 lekë
Cungishte 000 ha x 000 lek = 000 lekë
Shkurre 000 ha x 000 lek = 000 lekë
Inproduktive etj…000 ha x 000 lek = 000 lekë

**a/1) Vlera e përdorimit për linjat gjatësore në km, rrugë auto lidhëse, 31750 lekë/vit**

Trungishte 0.00 km x 000 lekë = 000 lekë
Cungishte 0.635 km x 50000 lekë = 31750lekë
Shkurre 0.000 km x 0 000 lekë = 0 000 lekë
Bimësi pyjore + djerr 0.00 km x 000 lekë = 000 lekë

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

**b) Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës 1200 lekë, e përbërë nga :**

1. Vlera e lëndës së punimit 000 lekë
2. Vlera e druve të zjarrit 1200 lekë
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 000 lekë
4. Kullotja 000 lekë
5. Vlera e faunës 000 lekë
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj) 000lekë.
7. Të tjera 000lekë

PËRPILUESIT E KËTIJË RAPORTI

Ing.Gjovalin Nikolli    Ing. Preng Nikolli    Ing.Eneida Nikolli

DREJTORI ABUAPYJOR

Ing.Kastriot Bica

**K O N F I R M O I**

**K R Y E T A R I**

**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË

PASQYRA E PËRSHKRIMIT PARCELAR (sipas rregjistrit kadastral, inventari i transferimit)

(Për Ndërtimin i rrugës, " Lagjja Ndrejaj ", Perlat-Epër. EP.Perlat- Shebe, Nj/Administrative Kthellë).

Formulari 1

| ID.i Pronës | Ekonomia pyjore/kullosore | Parcela nr. | Përbërja e grumbullit | Funksioni | Forma e qeverisjes | Të dhëna të grumbullit pyjor | | | | | | | Fuqia lendore m3 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Kl.Moshës | K.D | D mes | H mes | Filizeria | n/pylli | Katet | Për ha | Total |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| LE 31 00 25/b | Perlat-Shebe | 25/b | pyll | prodhues | cungjishte | 25 | 0.9 | 7 | 6 | - | - | - | 5 | 90 |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI

Ing.Kastriot Bica

BASHKIA MIRDITË

TABELA E PERSHKRIMIT TE SIPERFAQES KULLUSORE

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NE PERDORIM

(Për Ndërtimin i rrugës, "Lagjjaj Ndreja", Perlat- Epër. EP.Perlat- Shebe, Nj/Administrative Kthellë).

Formulari 2

| ID I Pronës | Ekonomia pyjore/kullosore | Parcela nr. | Bimesia në % Leguminae, graminae etj | Sip.sipas tipit të kullotes në | | | Ngarkesa në krere që kullosin | | | | Vlera e kullotes në 000/lekë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Dimerore | Verore | Total | Dhen | Dhi | Të trasha | Total | Ha | Total |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| | | | - | - | | | | | | | | |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Totali** | | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI

Ing.Kastriot Bica

BASHKIA MIRDITË

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NE PERDORIM
(Për Ndërtimin i rrugës, "Lagjja Ndrejaj", Perlat-Epër. EP.Perlat-Shebe, Nj/Administrative Kthellë).

Formulari 3

| ID I Pronës | Përdorimi | Ekonomia pyjore/kullosore | n/Parcela nr. | Sip.totale | Sipërfaqe me punime | Viti i kryerjes së punimeve | Punimi i kryer ne ha/m3 | | | Vlera e investimit në 000 lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Pyllëzim | Përmires | Sist.mal | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| Totali | | | - | - | - | - | - | - | - | - |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI

Ing.Kastriot Bica

BASHKIA MIRDITË

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT FINANCIAR

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NE PERDORIM

(Për Ndërtimin i rrugës, "Lagjja Ndrejaj", Perlat-Epër. EP.Perlat-Shebe, Nj/Administrative Kthellë).

Formulari 4

| Perdorimi i territorit | Siperf.në ha | Volumi m³ sipas asortimenteve | Vlera | | Sipërfaqe në ha | Gjatesia e përdorimit në km | Tarifa dhënie ne perdorim lek/km/vit | | | Shuma II lekë | TOTALI I+II lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | lek/m3 | Shuma I | | | 1 | 2 deri 5 | 6 deri 10 | | |
| 0 | 1 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| Trungjishte | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Cungjishte | 0 | 2 | 600 | 1200 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1200 |
| Cungjishte | 0.222 | 0 | 0 | 0 | 0.222 | 0.635 | 0 | 0 | 50000 | 31750 | 31750 |
| Shkurre | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Kullote | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bimesi pyjore+Djerr | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Inproduktive | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Bime mjek/med | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjuetia | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Invest realizuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali** | **0.222** | **0** | **0** | **1200** | **0.222** | | **0** | **0** | **0** | **31750** | **32950** |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI

Ing.Kastriot Bica

BASHKIA MIRDITË

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QË JEPEN NE PERDORIM
(Për Ndërtimin i rrugës, "Lagjja Ndrejaj", Perlat Epër. EP.Perlat Shebe, Nj/Administrative Kthellë).

Formulari 5

| Nr | ID prones | Ekonomia pyjore kullosore | n/Ngastra/nr | Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/kullosor | Sipërfaqja që jepet në përdorim nga fondi pyjor/kullosor | Gjatësia në përdorim km | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Rrugë auto | Linjë | Tubacion/kanal |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| 1 | LE 31 00 25/b | Perlat-Shebe | 25/b | 0 | 0.222 | 0.635 | 0 | 0 |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| - | - | - | - | - | - | - | - | - |
| **Totali** | | | | | | | | |

PLOTESOI: Ing. Eneida Nikolli

Ing. Gjovalin Nikolli

Ing. Preng Nikolli

DREJTORI

Ing.Kastriot Bica